



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën

Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Vijimi i procedurës së shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2017, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Caktimi i detyrave për ekspertët konstitucionalistë

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi.

Mungojnë:

Jurgis Çyrbja, Astrit Veliaj, Nasip Naço, Tom Doshi, Ermonela Felaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Silva Caka, Edmond Haxhinasto, Enkelejd Alibeaj, Edmond Leka,

Të ftuar:

Lefterije Luzi – Drejtore e Shërbimit të Komisioneve

Moza Arbri – Këshilltare Juriste

Moza Pano – Drejtore e Shërbimit të Seancave Plenare

Iva Seseri – Këshilltare juridike

Isida Koka – Këshilltare juridike

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Të nderuar deputetë, hapim mbledhjen e përbashkët të Komisionit të Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut dhe Këshillit për Legjislacionin.

Kjo mbledhje zhvillohet në vijim të procedurës së shqyrtimit të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21. 10. 1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”. Objekt i kësaj mbledhjeje janë pyetjet dhe përcaktimi i detyrave për ekspertët konstitucionalistë.

Përpara se të fillojmë, sjell në vëmendjen tuaj që procesverbali i mbledhjes së mëparshme u është dërguar me *e-mail*. Nëse keni ndonjë vërejtje për të, ju lutem ta thoni. Nuk ka.

Sikurse është përcaktuar edhe në kalendarin e shqyrtimit për këtë projektligj, po vijojmë sot me shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21. 10. 1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Kalendarin e zbardhur e keni të gjithë përpara.

Së dyti, për sa i përket propozimit që u bë në mbledhjen e mëparshme nga përfaqësuesit e maxhorancës për të kërkuar opinionin e Komisionit të Venecias për draftin e ndryshimit të Kushtetutës, ju informoj se në cilësinë e Kryetarit të Kuvendit kam përcjellë ditën e djeshme pranë Komisionit të Venecias nismën e depozituar për rishikimin e Kushtetutës, si dhe pyetjet që u depozituan për këtë nismë. Në mbledhjen e kaluar u bë prezantimi i nismës nga nismëtarët, u caktuan relatorët, u përcaktua mënyra e njohjes së projektligjit nga zgjedhësit dhe ramë dakord për konstitucionalistët, emrat e të cilëve i ka propozuar 1 opozita dhe 2 maxhoranca. Sot janë të pranishëm në mbledhjen e komisionit ekspertët: zoti Gazmend Bardhi, zoti Artur Metani dhe zoti Gledian Llakja.

Artur Metani - Zoti Llakja nuk është paraqitur për shkak të një angazhimi profesional tjetër, por do t’i marr unë pyetjet për të.

Gramoz Ruçi - Në rregull!

Unë i përmenda emrat edhe për efekt të transparencës, edhe për publikun dhe mediet. Ndaj, edhe një herë, dua t’ju falënderoj që jeni prezentë këtu dhe iu përgjigjet pozitivisht ftesës së bërë nga përfaqësitë përkatëse të grupeve parlamentare, me shpresën dhe besimin e plotë që në vazhdimësi të shqyrtimit të këtij projektligji ju do të jepni kontribut të vyer qoftë për anëtarët e Komisionit të Ligjeve, qoftë për anëtarët e Këshillit të Legjislacionit, por edhe për opinionin publik lidhur me asistencën tuaj konstitucionaliste!

Tani, sipas rendit të ditës dhe siç e thashë, kjo mbledhje është për t'u lënë detyrat ekspertëve, për të vazhduar pastaj me seancat në vijim.

Ju lutem, kush e do fjalën?

Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti Kryetar, ju përmendët se në vijim të vendimit që morët për t'ia dërguar Komisionit të Venecias, në mos gaboj, thatë se materiali është dërguar dje. Kështu që, duke u nisur edhe nga eksperiencat më të hershme, ku Komisioni i Venecias është keqdrejtuar, në gjykimin tonë, qëllimshëm nëpërmjet materialesh të përkthyer gabim ose pyetjesh të cilat mund të mos i përgjigjen fare çështjes, kërkoj të na vihet në dispozicion materiali që i është nisur Komisionit të Venecias (e gjithë dosja që i është dërguar), në mënyrë që të kemi mundësinë që ta shqyrtojmë. Kjo është kërkesa e parë procedurale.

Nëse mund të më lejoni, të vazhdoj me diçka që kam për të thënë? Më pas do të bëj edhe një propozim procedural për të lehtësuar...

Të nderuar kolegë të kësaj mbledhjeje të përbashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve, ajo që na sjell ne sot këtu nuk është thjesht propozimi kushtetues për ndryshimin e Kushtetutës që opozita ka bërë për të bërë atë që e quajmë “Vetingu i politikanëve” për të dekriminalizuar politikën, sepse ai është instrumenti të cilin, në interes të publikut, ne po kërkojmë ta përfshijmë në Kushtetutë dhe më pas në ligj, në mënyrë që ta shpërbëjmë këtë lidhje, pasi lidhja, në fakt, problemi që na sjell ne sot, së bashku në këtë debat, ku dukshëm jemi me palë, nuk jemi bashkë, është lidhja krim – politikë dhe lidhja e interesave kriminale me interesat politike.

Për fat të keq, tashmë kjo lidhje funksionon në kanale të shumëfishta, të ndryshëm.

Unë do të identifikoj katër forma të politikanëve të lidhur me krimin, në një formë ose në një tjetër:

Forma e parë, për të cilën kemi gjetur një instrument, që është ligji i dekriminalizimit, është politikani me CV kriminale të drejtpërdrejtë, me dënim kriminal.

Forma e dytë është politikani, që përfaqëson një familje kriminale të drejtpërdrejtë në lidhje gjaku. Pra, nuk kemi më kriminelin, por kemi të afërmin, fëmijën, kushëririn e kriminelit apo edhe përfaqësuesin, thjesht ushtarin e kriminelit. Ditët e fundit e kemi parë fare qartë sesi kjo kategori nuk ka zgjidhje në ligjin e dekriminalizimit.

Forma e tretë është politikani në tentativë për të marrë një vendim dënimi penal nga gjykatat shqiptare. Në ditët e fundit ne e kemi fare të dukshme këtë situatë, ku grupe kriminale të mirënjohura, me prezencë të tyre edhe në grupin parlamentar të maxhorancës,

vetëm për faktin se ende nuk kanë një dënim penal, ligji i dekriminalizimit nuk i kap, por problemi i madh është aty, në parlament.

Forma e katërt, më e rrezikshmja, që na bën palë kundërshtare në këtë debat, është politikani që ka vendosur t'i hapë portën krimit nëpërmjet parlamentit, të parit, dhe më pas institucioneve të tjera. Politikani i hapë portën krimit nëpërmjet interesash kriminale që penetrojnë në financat publike, në jetën shoqërore dhe në Kushtetutë. Qëllimi kryesor i propozimit tonë për Vetingun e politikanëve është pikërisht vendosja e një filtri shtesë, që sot mungon, për të zhdukur këtë pjesë të penetrimit kriminal në institucion.

Të nderuar kolegë, të vetmit që dëmtohen nga propozimi ynë janë ato që kanë lidhje me krimin, asnjë tjetër. Ky nuk është shqetësim për askënd dhe as për opinionin publik, përkundrazi, opinionin publik kërkon pikërisht këtë: që këta politikanë të lidhur me krimin të mos jenë në parlament, të mos jenë në institucionet kushtetuese, të mos jenë në krye të bashkive dhe të mos jenë në pushtetin publik.

Besoj se ju të gjithë e dini dhe jeni të ndërgjegjshëm se ajo që propozojmë ne, vetingu i politikanëve, nuk ka asnjë lidhje me Vetingun në drejtësi, sepse janë dy procese administrative që shkojnë paralelisht dhe kanë të njëjtin të qëllim. Gjyqtarët dhe prokurorët e lidhur me krimin të ikin; politikanët, (deputetët, ministrat, kryetarë bashkie apo në institucione të tjera kushtetuese) të ikin nga institucionet publike. E njëjta gjë, nuk përplasen, nuk kryqëzojnë rrugën e njëri-tjetrit.

Gjithashtu, besoj se e keni shumë të qartë që Vetingu i politikanëve, me propozimin tonë, nuk pengon në mënyrë absolute hetimin penal dhe vënien para drejtësisë të çdo politikani që lidhjen me krimin e çon më lart se sa thjesht një lidhje, por e çon në vepër kriminale. Madje ky Veting do t'i japë mundësinë drejtësisë, SPAK-ut dhe BKH-së që të ketë më shumë informacion për t'i çuar para drejtësisë.

Sigurisht, ka një fushatë keqinformuese nga Kryeministri për ta përzier dhe për ta bërë në dukje të pamundur këtë Veting, ku unë besoj se shqiptarët e thjeshtë e kanë shumë të qartë dhe shqiptarët e thjeshtë kërkojnë pikërisht këtë. Pa pritur se kur do të ngrihet sistemi i ri i drejtësisë, diku në të ardhmen, apo pa pritur se kur do të jenë zgjedhjet, sot të fillojë pastrimi i politikës, që të paktën kur të vijnë zgjedhjet e tjera, institucionet e tjera të jenë vërtet më të pastra.

Sot, në emër të opozitës, dua të them disa elemente të rëndësishme, që besoj se duhet t'i keni parasysh në këtë proces. Opozita nuk do të pranojë dhe nuk do të tolerojë asnjë vonesë në miratimin e Vetingut të politikanëve. I gjithë ky proces këtu, ky kalendar që keni miratuar, e kemi thënë edhe herën e kaluar, e përsërisim, nuk ka qëllim tjetër, veçse vonesën,

zvarritjen dhe mundësinë të harrohet apo të tretet, por kjo nuk do të ndodhë. Ky propozim do të shkojë deri në fund. Shqiptarët e mbështesin vetingun e politikanëve sado të përpiqeni që të thoni diçka tjetër, është në dëmin tuaj, sepse ju pozicionon keq. Por, nga ana tjetër, ju kuptoj, sepse Kryeministri, Edi Rama, e ka thënë fjalën e tij, ka thënë: “Jo, unë nuk jam për këtë”, pra nuk e do vetingun e politikanëve. Sa më gjatë të kemi politikanë të lidhur me krimin në institucione, duke filluar nga parlamenti e tutje, aq më shumë do ta kenë keq shqiptarët, sepse aq më shumë do të ketë përdhunim të grave dhe vajzave, aq më shumë do të ketë fëmijë që rrihen nga një shtet brutal, aq më shumë dhunim të pronës publike dhe të interesit publik do të ketë.

Ngjarjet e fundit, përfshirë deklaratën e jashtëzakonshme dhe përpara gjykatës të personit, i cili sot është simboli i momentit për këtë e provojnë këtë lidhje me krimin dhe bashkëqeverisja me krimin ka sjellë emergjencë kombëtare. Po bëni çdo gjë për ta zvarritur këtë proces, por dekriminalizimin e politikës nuk e ndaloni dot. Kuvendi dhe qeveria sot janë praktikisht në duart e krimit dhe simbioza me krimin ka shkuar edhe më tej, sepse sot po qeverisin kriminelët.

Nëpërmjet kësaj PPP-je kriminale, ku i keni bërë *outsourcing* pushtetit të krimit, sot *de facto* në të gjithë territorin bandat kontrollojnë mënyrën e qeverisjes së shqiptarëve.

Opozita është e vendosur që kësaj t’i japë fund. Ne do ta çojmë para këtë çështje, përtej çdolloj pengese që do të vendosni, në të kundërt vetingun e politikave do ta bëjnë njerëzit dhe jo ashtu siç mendoni ju, por në një mënyrë tjetër. Kështu, besoj se është në qëllimin tonë të përbashkët që ju të mos fshiheni pas gishtit.

Për të mos u zgjatur më tej, unë propozoj që pyetjet tona në lidhje me këtë çështje t’i depozitojmë në formë të saktë në sekretarinë e komisionit për ekspertët. Ekspertët duhet të na japin përgjigjet e tyre për këtë çështje sipas pyetjeve tona. A jeni dakord me këtë propozim?

Gramoz Ruçi – A do t’i paraqisni pyetjet tuaja?

Oerd Bylykbashi - Po, ne do t’i depozitojmë me shkrim, që të jenë të sakta.

Gramoz Ruçi – Patjetër që do t’i depozitoni me shkrim, por në qoftë se i keni pyetjet...

Oerd Bylykbashi - Për efekt të saktësisë pyetjet do të merren prej jush dhe më pas ju mund t’i bëni publike.

Gramoz Ruçi - Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Faleminderit, Kryetar!

Në fakt, edhe ne i kemi gati pyetjet me shkrim për ekspertët konstitucionalistë dhe do t'i depozitojmë. Unë do të flas shumë shkurt lidhur me sa parashtroi kolegu Bylykbashi, sepse fjalët e tepërta janë fukarallëk.

Ne, si maxhorancë, e kemi shprehur qëndrimin tonë të qartë në lidhje me nismën e Partisë Demokratike për ndryshimin e Kushtetutës. Në rrafshin politik qëndrimi ynë ka qenë, është dhe do të jetë absolutisht në mbështetje të çdolloj vetingu të politikës. Këtë gjë e kemi demonstruar me votë dhe vota jonë ka qenë pro kur ndryshuam Kushtetutën, ka qenë pro kur miratuam ligjin e dekriminalizimit, gjithashtu ka qenë pro dhe e palëkundur, konsistente, edhe për reformën në drejtësi. Sigurisht, ne jemi për pastrimin e politikës, madje në këndvështrimin tonë kjo nismë është e cunguar për arsye se lë jashtë vetingut të politikës rrethin e gjerë të subjekteve, qoftë personat e afërm, familjarë të politikanëve, apo edhe personat fizikë dhe juridikë, që kanë lidhje të hapura dhe të drejtpërdrejta ose të fshehura biznesi me politikanët. Për këtë, në kuadër të reformës në drejtësi, ne kemi mbështetur fort institucionet e posaçme për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në radhët e zyrtarëve të lartë të shtetit pa dallim.

Ndërsa në rrafshin kushtetues dhe ligjor, qëndrimi ynë ka qenë i qartë në mbledhjen e parë të këtij Këshilli, ne kërkojmë, as më shumë dhe as më pak, respektimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por dhe të Rregullores së Kuvendit. E theksova edhe në fjalën time, në mbledhjen paraardhëse, bëhet fjalë për të ndryshuar apo për të ndërhyrë në ligjin themeltar të shtetit, që është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Nismën e opozitës e kemi marrë në konsideratë, por, natyrisht, do t'i nënshtrohet një diskutimi të gjerë me konstitucionalistët, ekspertët e fushës, pse jo edhe marrjen e një opinionit nga Komisioni i Venecias. Më lejoni të përdor një fjalë që është përdorur nga opozita në kohën e diskutimeve për reformën në drejtësi, Venecia është tabani i demokracisë.

Meqenëse kjo nismë ka edhe implikime me ligjin e dekriminalizimit, po ashtu edhe me kuadrin ligjor që kemi në fuqi, këtu e kam fjalën për paketën “antimafia”, ku përgjegjëse e zbatimit për këtë paketë do të jetë edhe Byroja Kombëtare e Hetimit, kërkuam që kjo nismë t'i drejtohet Komisionit të Venecias.

Jemi dakord me atë që parashtroi kolegu, që pyetjet të depozitohen me shkrim, gjithashtu të njihen edhe me të gjithë praktikën që i është dërguar Komisionit të Venecias. Opozita është në kohë, ndoshta t'i drejtohet me pyetje Komisionit të Venecias lidhur me nismën që ka shkuar në Venecia, për të pasur një tablo të qartë për konsiderimin e kësaj nismë nga kjo mbledhje e përbashkët.

Gramoz Ruçi – Meqenëse u ra dakord, pyetjet të depozitohen në sekretari dhe t'u vihen në dispozicion ekspertëve konstitucionalistë, që ata të fillojnë menjëherë përgatitjet.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Në mbledhjen e kaluar, nga prezenca e opozitës vumë re një padurueshmëri për ta bërë sa më shpejt këtë. Nisur nga fakti që sot opozitarët nuk janë ende prezentë dhe kërkojnë ende kohë për të depozituar pyetjet, mendoj se nuk duhet të humbasim kohë, sepse nuk do ta kapim kohën 1-javore që kërkonte Partia Demokratike për ta futur...

Gramoz Ruçi – Jo, nuk ka kërkuar kohë, të lutem, por tha vetëm se pyetjet i ka gati dhe do t'i depozitoj sot!

Oerd Bylykbashi – Zoti Kryetar, pyetjet janë gati dhe do të depozitohen në sekretari, kështu që shqetësimi i kolegut është i pavend.

Gramoz Ruçi – Atëherë jemi dakord lidhur me kërkesën që u bë për të vënë në dispozicion materialin. Moza, të lutem, zotit Oerd t'i vihet në dispozicion materiali i firmosur dhe nga unë për Komisionin e Venecias në shqip dhe në anglisht.

Këtu mbyllim këtë çështje të rendit të ditës për sot.

Do t'ju lutesha të procedojmë me kalendarin e miratuar nga Komisioni i Ligjeve lidhur me seancat dëgjimore. Besoj se edhe për arsye menaxhimi 3 nga pozita, 2 nga opozita, të fiksohen emrat dhe t'i jepen administratës së Kuvendit me qëllim që të ndiqet kalendari i punimeve.

Ajo që doja t'ju thosha si rekomandim është që kryetari dhe nënkryetari i Komisionit të Ligjeve, kryetari i Këshillit të Legjislacionit, dy relatorët, është mirë të jenë në seancat dëgjimore, megjithatë është e drejta e gjithkujt dhe unë nuk mund të detyroj askënd që të marrë pjesë në këto seanca dëgjimore.

Oerd Bylykbashi -Kryetar, merri të gjitha masat që procesi të funksionojë shpejt, vonesat e tepërta, përveçse janë të qëllimshme, nuk i shërbejnë interesit publik.

E përsëris ky proces, vetingu i politikanëve duhet bërë dhe duhet bërë shpejt. Çdo lloj kalendari vonues është i papranueshëm. Një gjë duhet të kemi të qartë, nëse ne nuk pastrojmë këtë lidhje të krimit me politikën, në këtë vend nuk do të ketë as zgjedhje, as demokraci, as parlament dhe as ekonomi. Kështu që përpikuni që me procedurë të mos vrisni interesin e publikut për të pastruar politikën nga krimi.

Gramoz Ruçi – Absolutisht nuk do të ketë asnjë zvarritje, do të zbatohet një për një, prandaj jemi këtu. Kolegët që unë përmenda, anëtarët e tjerë të Komisionit të Ligjeve dhe anëtarët e Këshillit të Legjislacionit, janë të lirë të marrin pjesë, por kryetari i komisionit, nënkryetari i Komisionit të Ligjeve, kryetari i Këshillit të Legjislacionit dhe të dy relatorët do

të jenë në të gjitha seancat dëgjimore. Prandaj të kontaktohet, të merren masat për këtë çështje dhe të vazhdojë puna. Ndërkohë, paralelisht konstitucionalistët në momentin që do të jenë gati, do të na njoftojnë për të mos pasur zvarritje, prandaj u shpejtua që brenda dy ditëve iu nis Komisionit të Venecias, me qëllim që kur të vijë dita për të diskutuar projektligjin në parim dhe nën për nën, të kemi edhe mendimin e konstitucionalistëve, edhe mendimin e seancave dëgjimore, edhe ekspertizën e Komisionit të Venecias.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.